



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 03.04.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Bahrim Shabani, Glauk Konjufca, Igor Simiç dhe Skumbin Demaliaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Dibran Istrfi-Klan Kosova; Ridvan Hamza-KTV; Sahadeta Zogaj-KosovaPress; Liridona Xhemalji-RTV21; Shaban Murturi-EUO/EUSR; Edita Kusari-EUO/EUSR; Rreze Hoxha-GLPS; Gresa Ramadani-Vizitor; Labinot Leposhtica-BIRN; Gëzim Shala-IKP/BPdD; Agnesa Haxhiu-KDI; Sanije Berisha-OSBE dhe Mejreme Tahirukaj-Radio Kosova.

Mbledhjen e kryesoi, kryetarja e komisionit Albulena Haxhiu.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Amnistinë;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-055 Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-062 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Ekstradim;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Amnistinë

Kryetarja tha se ky projektligj është nismë e më shumë se gjashtë deputetëve. Ajo tha se nuk do të jap mendim në lidhje me këtë projektligj për arsye sepse ky projektligj ka të bëjë direkt me veprimet politike të cilat janë ndërmarrë në seancat e mandatit të kaluar në përpjekje për të ndalur marrëveshjet e dëmshme, demarkacionin dhe asociacionin e komunave, pra deputetja Haxhiu tha se nuk do të marrë pjesë as në diskutim as në votim për shkak të konfliktit të mundshëm të interesit.

Bilall Sherifi tha se ky projektligj ka për qëllim tejkalimin e një situate të acaruar në atë kohë kur opozita e atëhershme kundërshtonte demarkacionin dhe asociacionin, dhe duke konsideruar se tani më ajo situatë është e tejkaluar kam mbështetur iniciativën për një projektligj përmes të cilit do të përmbylej ajo pjesë e historisë parlamentare të Kosovës dhe si anëtar i komisionit dhe si kryetar i grupit parlamentar të Nismës do ta mbështesë, tha z. Sherifi. Ky projektligj është mirë të ketë mbështetje nga të gjithë, e sidomos nga pjesa që ishte kundërshtuese në marrëveshjet e përmendura më lart.

Hajdar Beqa tha se me këtë projektligj trajtohen kushtet dhe procedurat për vendosjen e amnistisë për deputetët e Kuvendit të Kosovës, të cilët janë në ndjekje penale apo deputetët të cilët mund të jenë objekt i ndjekjes penale për veprat penale të kryera gjatë periudhës 25 gusht 2015-10 maj 2017. Z. Beqa tha se edhe gjatë periudhës 2018 kishte raste kur është hedhur gaz në Kuvend dhe për këtë ai propozoi që periudha nga 25 gusht 2015-10 maj 2017 të vazhdohet deri në mars 2018, pra deri në ditën kur është shënuar pika kufitare mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi.

Sami Kurteshi- tha se faza e kundërshtimit politik për çka është përdorur gazi lotsjellës politikisht nuk ka kaluar, gjithashtu ky ligj në këtë fazë nuk do ta arrijë synimin që ka. Në atë kohë ishin dy marrëveshje të dëmshme të cilat janë kundërshtuar, ku njëra nga to ka kaluar edhe pse Lëvizja Vetëvendosje e ka kundërshtuar. Deputeti Kurteshi gjithashtu mbështeti propozimin e deputetit Hajdar Beqa.

Korab Sejdiu në fjalën e tij paraqiti qëndrimin e grupit parlamentar, ku tha se kundërshton kalimin e ligjit për amnisti sepse konsiderohet që nuk është mënyra e duhur për ta trajtuar këtë çështje. Ndërsa në nivel personal ai tha se ky ligj tejkalon qëllimin të cilin ka, duke pasur parasysh që këto janë vepra penale të cilat kryhen me dashje e jo nga pakujdesia dhe për këtë arsyeje kjo çështje është dashur të ngritet dhe trajtohet nga gjykata, pra çështja e mungesës së nënstrehës apo qëllimit kriminel dhe mbrojtja e nevojshme, kur dihet se të gjithë ata që kanë kryer këto vepra e kanë bërë të qartë qëllimin e kryerjes së veprës. Deputeti Sejdiu theksoi nevojën e sqarimit të nenit 75 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Nuk mendoj se ky ligj është i duhuri që të adresohet kjo çështje kur e dimë se edhe ligji nuk është i hartuar mirë dhe është diskriminues edhe për ata që kanë kryer vepra të ngjashme më vonë. Në fund ai tha se grupi parlamentar nuk e përkrah ligjin për amnisti, gjithashtu kërkoi nga komisioni që të ketë parasysh trajtimin e nenit 75, pika 1 të Kushtetutës.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se me 4 (katër) vota për, 1 (një) kundër dhe 1 (një) abstenim vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë;

R e k o m a n d i m

Te mos miratohet, në parim Projektligji për Amnistinë

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Kryetarja tha se Projektligji për Këshillin Gjyqësor dhe për Këshillin Prokurorial të Kosovës rregullojnë pothuajse çështje të njëjta, por megjithatë nëse kalon në komision do të ketë nevojë që të ketë shumë amendamente për shkak që nenet të jenë më të kuptueshme.

Sami Kurteshi paraqiti një varg vërejtjesh për Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si vijon: neni 2, neni 3, paragrafi 1, pika 1.1; neni 3, pika 1.4; neni 3, pika 1.5; neni 5, paragrafi 1; neni 7, pika 1.3; neni 7, pika 1.5; neni 8; paragrafi 5; neni 9, pika 1.5, paragrafi 1; neni 10, paragrafi 3, ku flitet për konkursin e anëtarëve të Këshillit i cili shpallet nga Kuvendi. Ai tha se kuvendi nuk është dashur të shpallë konkurs për një institucion të pavarur siç është Këshilli Gjyqësor dhe as të zgjedhë anëtarët e Këshillit Gjyqësor, potencoi z. Kurteshi. Vërejtje kishte edhe në nenin 10, paragrafi 7; nenin 11, paragrafi 1; neni 11, paragrafi 2, pika 2. 2; nenin 11, pika 2.6; neni 12, paragrafi 1; neni 15, paragrafi 3; neni 19, paragrafi 2; neni 20, pika 2.3 paragrafi 2; neni 21, paragrafi 1. Të gjitha këto vërejtje deputeti Sami Kurteshi tha se do t'i paraqes edhe me shkrim.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri votoi në pako Projektligjin nr. 06/L-055 Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Projektligjin nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë;

R e k o m a n d i m

- I. Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;**
- II. Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.**

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-062 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Ekstradim

Sami Kurteshi përmendi rastin e gjashtë shtetasve turq dhe tha se me këtë rast Kosova ka shkelur marrëveshjen kryesore në të cilën bazohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Komisioni shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-062 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës e Kosovës dhe Hungarisë për Ekstradim dhe me gjashtë vota “për” vendosi që Kuvendit t’ia paraqes këtë;

R e k o m a n d i m

Të mos miratohet Projektligji nr. 06/L-062 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Ekstradim

6. Të ndryshme.

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu